



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 444/20

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 05.06.2020

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38, datë 31.05.2020, Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Korona Virusi, COVID-19, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e Korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrisë, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Fëmijët – nxënës të klasëve të 9-ta dhe personeli tjetër i shkollave në Komunën e Vushtrisë, në familjet e të cilëve ka persona të infektuar me virusin COVID-19, nuk do të vijojnë mësimin në shkollat e tyre deri në një vendim tjetër të Shtabit Emergjent, për shkak të rrezikut të përhapjes së këtij virusi te nxënësit tjerë apo personelit tjetër i punësuar në ato shkolla.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria Komunale për Arsimit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.




Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për
- Arkivit të Sekretarisë




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Shtabi Emergjent për Mbrojtje nga COVID-19

Bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/38, datë 31.05.2020, Shtabi Komunal Emergjent për Mbrojtje nga Korona Virusi, COVID-19, pas shqyrtimit të gjendjes së krijuar nga përhapja e Korona virusit në ditët e fundit në Komunën e Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet blerja e njëqind (100) pakove ushqimore dhe higjienike në vlerë deri në pesëdhjetë euro (50,00 €) të cilat do të iu shpërndahen familjeve që janë tani aktive, të prekura me COVID-19 në Komunën e Vushtrrisë.
2. Mjetet financiare për blerje të pakove të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga kodi buxhetor i komunës i dedikuar për mbrojtje nga COVID-19.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Komisioni Komunal për shpërndarje të ndihmave me pako ushqimore dhe higjienike.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës – Kryesues i
Shtabit Emergjent

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Prokurim Publik
- Arkivit të Sekretarisë